




### Deklaratat e analizuara:

12 Deklarata të analizuara

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2007 deri Periodik/Vjetor 2018)

## Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklaramit deri në vitin 2018

### Ndryshimi i Pasurisë ndër Vite



Pasuria bruto është rritur 1.1 herë.

+ 94,089 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë.

## Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë

Likuiditete në Cash

50,000

Para Fillimit të Detyrës Datë 31/12/2018

1,000,000

Para Fillimit të Detyrës Datë 31/12/2018

Pasuritë e Luajtshme

Pasuritë e Paluajtshme

7,306,800

Para Fillimit të Detyrës Datë 31/12/2018

7,512,286

## Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruase

Të Ardhurat 2008-2018	Shuma në Lekë	Raporti në %
Paga nga funksioni	12,227,844	46.1%
Paga e familjarëve	6,359,493	24.0%
Të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme	2,242,240	8.5%
Dhurata në Cash	5,687,107	21.4%
<b>Total</b>	<b>26,516,684</b>	<b>100%</b>



## Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 11 vite rezultoi:

**Pa Probleme**

Subjekti Lazer Sallaku në vitin 2010 deklaroi transferim/kalim pronësie si pasojë e ndarjes në emër të ish-bashkëshortes të asetit shtëpi banimi me vlerë 60,000 euro si dhe detyrimin për pagesën e kredisë bankare marrë për blerjen e këtij aseti.

Në vitin 2012, subjekti deklaroi gjendje cash prej 40,000 eurosh në emër të bashkëshortes, dhuruar nga nëna e saj me rastin e martesës.

Në vitin 2014 deklarohet pagesa e dy kësteve me vlerë totale 30,727 për ndërtimin e një apartamenti në komunën Farkë, me burim pakësimin e gjendjes cash. Në deklarim mungon vlera e plotë e apartamentit, por bazuar në këstet e deklaruara rezultojnë 46,323 euro si dhe detyrim i papaguar ndaj firmës prej 15,596 euro.

Gjatë këtij viti deklarohet të ardhura 16,000 euro nga shitja e një apartamenti banimi, i përfituar nga bashkëshortja nëpërmjet trashëgimisë familjare (vlera e shitjes 32,000 euro, pjesë takuese 50%), shumë e cila mbahet cash në banesë.

Në vitin 2016 deklarohet pakësimi i gjendjes cash 16,000 euro, i cili shërben për blerje pasuri e paluajtshme garazh 7,547 euro dhe pagesë e këstit të fundit të detyrimit ndaj firmës së ndërtimit.

Në vitin 2017, subjekti deklaroi huamarrje 11,000 euro dhe kredi bankare 36,000 euro, të cilat shërbejnë për t'i paguar ish-bashkëshortes shumën 45,000 euro sipas marrëveshjes për ndarje pasurie dhe regjimi pasuror pas zgjidhjes së martesës, e cila heq dorë nga pjesa e saj si bashkëpronare në pasurinë e paluajtshme apartament banimi dhe garazh.